

RELACION
MBI PROJEKTLIGJIN PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9918, DATE
19.5.2008 “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISE”, TË NDRYSHUAR,

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka si qëllim të krijojë hapësirën e duhur ligjore për AKEP për rregullimin e tarifave të roamingut ndërkombëtar, tarifave me pakicë të përdoruesve celularë të operatorëve Shqiptarë kur këta vizitojnë vendet e tjera dhe tarifave me shumicë që operatorët e vendeve të tjera paguajnë kur përdoruesit e tyre vizitojnë Shqipërinë, si dhe të tarifave të shërbimeve të lidhura me roamingun ndërkombëtar.

Përmes këtij ndryshimi i hapet rruga ligjore zbatimit të rregullimit të roamingut nga AKEP me Kosovën (Zero Roaming), si dhe me vende të tjera të rajonit mbi bazën e marrëveshjeve reciproke bilaterale, multilaterale dhe rajonale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

III. BAZA LIGJORE

Ky projektligj është nismë deputeti dhe paraqitet për shqyrtim në Kuvend bazuar në nenin 81 pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Rregullimi i Roamingut ndërkombëtar midis vendeve të BE-së është kryer në nivel komunitar nga institucionet e BE-së, pa pasur nevojën e aktve legislative në nivel kombëtar. Ndërkohë që rregullimi i tarifave të roamingut ndërkombëtar në bazë të marrëveshjeve bilaterale, multilaterale apo rajonale kërkon bashkëpunim midis institucioneve të politikbërjes dhe të atyre rregullatore të vendeve përkatëse, si dhe kompetenca të duhura ligjore për rregullimin e këtij shërbimi, kur kryhet paralelisht në mënyrë reciproke midis 2 apo më shumë vendeve sipas marrëveshjeve përkatëse.

Mundësimi i rregullimit të tarifave të roamingut lidhet me zbatimin e angazhimeve të marra në Samitin e Triestes në 12 korrik 2017, për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale WB6. Në Planin shumëvjeçar për zonën Ekonomike Rajonale, (MAP-REA) të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në shtyllen dixhitale, është parashikuar rregullimi i roamingut në WB6 Perëndimor sipas modelit të Bashkimit Evropian.

A. Rregullimi roamingut ndërkombëtar në vendet e BE

Komisioni Evropian ka filluar rregullimin e roamingut ndërkombëtar midis vendeve anëtare të BE-së në vitin 2007 nëpërmjet miratimit të Rregullores Nr. 717/2007 (e njohur ndryshe si Roaming I Regulation), datë 17 Qershor 2017. Nëpërmjet kësaj Rregulloreje KE përcaktoi tarifa maksimale me shumicë dhe me pakicë dhe reduktime të tyre për roamingun ndërkombëtar midis vendeve anëtare për thirrjet zanore.

Më pas Komisioni ka vijuar reduktimin e tarifave roaming duke shtuar dhe shërbimet nën rregullim (SMS dhe data (Internet) nëpërmjet Rregullores Nr. 544/2009 (Roaming II Regulation) dhe Rregullores Nr. 531/2012 (Roaming III Regulation). Komisioni ka amenduar Rregulloren 531/2012, nëpërmjet Rregullores 2015/2120 (Telecom Single Market Regulation-TSM Regulation) dhe Rregullores 2017/920.

Nëpërmjet Rregullores Telecom Single Market (TSM Regulation), Komisioni vendosi për fillimin e aplikimit të Roam Like At Home duke filluar nga data 15 Qershor 2017. Nëpërmjet RLAH qytetarët në vendet anëtare të BE-së nuk kanë më tarifa/kosto shtëse me pakicë në faturat që kanë me operatorët vendas kur vizitojnë vende të tjera anëtare të BE-së. Për të mundësuar RLAH, Komisioni ka miratuar gjithashtu reduktime të mëtejshme të tarifave me shumicë të aplikuara midis operatorëve (Rregullore 2017/920), si dhe masa për përdorim të drejtë të shërbimeve me pakicë në RLAH (Rregullore 2016/2286), që përmban rregulla për të shmatur roamingun e përhershëm apo abuziv nga përdoruesit fundorë. Aktet legislative të BE-së janë shoqëruar me një sërë aktesh implementuese nga Komisioni dhe Udhëzime nga Grupi i Rregullatorëve Evropianë (BEREC).

B. Inisiativat për roamingun rajonal

Rregullimi i roamingut ndërkombëtar në vendet e BE-së është kryer nëpërmjet rregullimit në nivel komunitar nga institucionet e BE-së dhe ka sjellë përfitime të mëdha për qytetarët e vendeve anëtare të BE-së në përdorimin e shërbimeve celulare, sidomos rregullimi i fundit RLAH. Megjithatë këto rregullime aktualisht mund të aplikohen vetëm midis vendeve që kanë status të vendit anëtar të BE-së.

Vendet që aspirojnë për t'u bërë anëtare të BE-së nuk mund të përfshihen në këtë rregullim deri sa të marrin statusin Vend Anëtar, megjithatë, marrveshjet bilaterale, multilaterale dhe rajonale konsiderohen tashmë edhe nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU) si një instrument shumë i mirë për të reduktuar/eliminuar tarifat e roamingut ndërkombëtar.

Katër vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Mali i Zi, Serbia, B&H dhe Maqedonia, në vitin 2014 kanë nënshkruar një Marrëveshje Rajonale për Roamingun ndërkombëtar, e cila përcakton se tarifat roaming midis këtyre vendeve, tarifat me shumicë midis operatorëve celularë dhe tarifat me pakicë për t'u aplikuar për pajtimtarët e shërbimeve celulare gjatë roamingut në këto vende do të rregullohen sipas çmimeve të aplikuara midis vendeve të BE-së bazuar në Rregulloren Nr. 531/2012 të Paramentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 Qershor 2012. Rregullimi nga secili vend i tarifave roaming sipas kësaj

rregulloreje është kryer duke aplikuar reduktim të përshkallëzuar të tarifave me shumcië dhe me pakicë të roamingut ndërkombëtar.

Qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim dhe me AKEP, ka kryer procedurat për aderimin e Shqipërisë në këtë marrëveshje, duke i kërkuar këtyre vendeve përfshirjen e Shqipërisë në këtë marrëveshje.

Bashkëpunimi rajonal për roamingun ndërkombëtar është bërë pjesë Inisiativës së Ballkanit Perëndimor duke marrë dhe mbështetjen e Komisionit Europian, i cili po punon për asistencë për vendet e rajonit në këtë drejtim, nëpërmjet edhe Këshillit Rajonal për Bashkëpunim (RCC), organizëm që ka nxitur bashkëpunimin në këtë kuadër duke kryer një sërë takimesh të përbashkëta rajonale dhe studime për këtë çështje.

C. Roamingu ndërkombëtar me Kosovën

Kohët e fundit, Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 30.05.2018 ka miratuar një Rezolutë (Nr.06-R-004) për heqjen e Roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Sipas të dhënave të AKEP Kosova është vendi me të cilin shkëmbehet më shumë trafik në roaming ndërkombëtar në vendet e rajonit. Megjithëse operatorët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë kanë lidhur marrëveshje të favorshme për roamingun ndërkombëtar, vlerësohet se ka vend për përmirësim dhe zbatimin e modelit RLAH duke filluar me marrëveshje bilaterale Shqipëri-Kosovë do të sillte përfitime të mëdha për qytetarët e të dy vendeve.

Në një studim rajonal të kryer nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC) për rregullimin e roamingut në vendet e Ballkanit Perëndimor, është evidentuar nevoja e ndryshimeve ligjore në ligjin për komunikimet elektronike, për të mundësuar rregullimin e tarifave të roamingut nga AKEP.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk përafron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me detyrimin për zbatimin e ndonjë *acquis* specifik të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ligji 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 2 të nenit 55, “Rregullimi i tarifave” i jep të drejtë/kompetencë AKEP të zbatojë rregullimin e tarifave nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave për:

a) shërbimet e përfshira në skemën e shërbimit universal, të ofruara nga ofruesi i shërbimi universal, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji;

b) shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg në tregun përkatës.

Me qëllim që AKEP të ketë mundësinë e rregullimit të tarifave të roamingut ndërkombëtar, tarifave me pakicë të përdoruesve celularë të operatorëve Shqiptarë kur këta vizitojnë vendet e tjera dhe tarifave me shumicë që operatorët e vendeve të tjera paguajnë kur përdoruesit e tyre vizitojnë Shqipërinë, si dhe të tarifave të shërbimeve të lidhura me roamingun ndërkombëtar, është e nevojshme që në pikën 2 të nenit 55, të ligjit 9918/2008, të shtohet një pikë e vecantë për rregullimin e tarifave roaming nga AKEP në bazë të marrëveshjeve bilaterale, multilaterale apo rajonale të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë si më poshtë:

“Në nenin 55 pas shkronjës “b” të pikës 2, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje: “c) shërbimet e roamingut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare

dy ose shumë palëshe të dakordësuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime.”

Formulimi mban parasysh specifikat që ka ofrimi i shërbimit të roaming-ut, ku aplikimi i rregullimit me interes për konsumatorin shqiptar kërkon rregullimin me zbatim reciprok me vendet e tjera.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ndryshimi shërben për të rritur sigurinë ligjore të rregullimit të roamingut ndërkombëtar nga AKEP, në bazë të marrëveshjeve reciproke bilaterale, multilaterale dhe rajonale për roamingun ndërkombëtar, përfshirë marrëveshjen me Republikën e Kosovës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.